



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 1047, datë 16.12.2020

P Ë R

**PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN  
E RINDËRTIMIT TË SHKOLLËS 9-VJEÇARE “AT ZEF PËLLUMBI”,  
NJËSIA ADMINISTRATIVE SHËNGJIN, BASHKIA LEZHË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i” dhe “iii”, 16 dhe 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të shkollës 9-vjeçare “At Zef Pëllumbi”, njësia administrative Shëngjin, Bashkia Lezhë, në vlerën 226 500 000 (dyqind e njëzet e gjashtë milionë e pesëqind mijë) lekë pa TVSH.
2. Përdorimi i fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2020, për financimin e rindërtimit të shkollës 9-vjeçare “At Zef Pëllumbi”, njësia administrative Shëngjin, Bashkia Lezhë, do të jetë në vlerën 45 300 000 (dyzet e pesë milionë e treqind mijë) lekë pa TVSH dhe do të përballohet nga pjesa e financuar nga grantet e fondit të rindërtimit.
3. Caktimin e Bashkisë Lezhë si njësi zbatuese për rindërtimin e shkollës 9-vjeçare “At Zef Pëllumbi”, njësia administrative Shëngjin, Bashkia Lezhë.
4. Fondi për financimin e rindërtimit të shkollës 9-vjeçare “At Zef Pëllumbi”, i transferohet njësisë zbatuese, Bashkisë Lezhë.

5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

**K R Y E M I N I S T R I**

**EDI RAMA**

**Në mungesë dhe me porosi**

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**ERION BRAÇE**

**MINISTRI I SHETIT  
PËR RINDËRTIMIN**

**ARBEN AHMETAJ**



NR.PROT. 6445/1  
DATË 22.12 2020

MINISTRIT TË SHËTETIT PËR RINDËRTIMIN  
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË  
BASHKISË LEZHË  
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

**Sekretari i Përgjithshëm**

**Engjell AGAÇI**

